



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MIMOZA SADUHAJ**  
**ADRESA Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1**  
**Tirane**  
**TEL: 0692097547**

# **REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE**

**Nr. repertori: 466**

**Nr. koleksioni: 178**

**Tirane më 03/02/2023**

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

\*Akti noterial përbëhet nga 13 fletë



A2023053540017371526



A2023053540017371526

**AKTI I THEMELIT DHE STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“SKM J.V SH.P.K”**

Sot, më datë 03/02/2023 (dymije e njetzet e tre) , perpara meje Notere MIMOZA SADUSHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tirane, u paraqiten personalisht:

**THEMELUES:**

**Shoqëria STAR CONSTRUCTION shpk**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS J62028002O, me adresë Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga Ndre Mjeda, Zona Kadastrale 8220, Nr.Pasurie 7/260, 7/259, 7/336, 7/33, 7/34., përfaqësuar nga Administratori **Albert Allmuça**, atësia Fadil, amësia Qefkere, shtetas Shqiptar, lindur në Mumajes, Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Dibres; Nd. Nr.198; Njesia Administrative Nr. 8; Njesia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 12/12/1968, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035483786 dhe nr. personal G812120390.

**Shoqëria KOZMOS IMP-EXP shpk**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS J62403013I, d me adresë Jordan Misja, përfaqësuar nga Administratori **Ajet Ruzi**, atësia Haki, amësia Sadet, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Durresit; Nd. 85/1; H. 2; Ap. 10; Njesia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 11/05/1946, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 024424652 dhe nr. personal E605110511.

Te cilet hartojne kete Akt Themelimi dhe statut te shoqerise “ **SKM J.V**“ **SHPK**, mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“, i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007“Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:

**KREU 1**

**Neni 1**  
**Krijimi**

Shoqeria “**SKM J.V**” **SHPK**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2**  
**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.



A2023053540017371526

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "SKM J.V" shpk, është një shoqëri, që themelohet ndërmjet ortakeve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

### Neni 3

#### Selia

Shoqëria e ka selinë në Tiranë në rrugën me adresë Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga Ndre Mjeda, Zona Kadastrale 8220, Nr.Pasurie 7/260, 7/259, 7/336, 7/33, 7/34 .

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakeve të Shoqërisë.

### Neni 4

#### Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është :

- Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë;
- Prodhimi i gazit; shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve;
- Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastrukturën e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë;
- Asistenca teknike, riparime dhe mirëmbajtja e aparaturave për prodhimin e energjisë. Import-eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë;
- Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji, etj;
- Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë nga burime të rinovueshme;
- Importi dhe eksporti i mallrave e pajisjeve të teknologjisë në fushën e energjetikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve me impiante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme dhe nga ato të caktuara si: hidroelektrike, diellore, me erë, biomasa etj;
- Mirëmbajtja e centraleve energjitike;
- Zhvillim të projekteve në sektorin e energjive të rinovueshme, ndërtimin dhe mirëmbajtje të punimeve civile, objekteve të ndryshme, linjave elektrike, kërkim dhe zhvillim të shpellave dhe minierave.
- Në fushën e projektimit në ndërtim , studime plane racionale urbanistike, plane rregullues të përgjithshëm për qendra të banuara , qytete , studime urbanistike , studime pjesore urbanistike , projektme objekte civile , industriale , turistike deri pesë kate , projektme objekte civile , industriale , turistike mbi pesë kate , projektme objekte sportive , projektme interiere , projektim pejsazhesh sistemime sipërfaqe të gjelbra lulishte . furnizim me ujë , kolektore shkarkimi , ujesjellësa kanalizime urbane , rurale , rrugë auto kategoria V e IV , projektim shtresa rrugore e sistemim asfaltim , projektim urra e vepra arti deri 10 m , Në zbatim në ndërtim germime dheu në punime eventuale , murature e beton arme , prishje dhe në toke të germuar , Ndërtime civile industriale , turistike , bujqësore deri 5 kate ndërtime civile industriale turistike bujqësore mbi pesë kate , rikonstruksione .Ndërtim banesë me skelet mbi tete kate , Ndërtim rrugë kategoria IV e V , ndërtim rrugë kategoria III , II , I , punime të



A2023053540017371526

mirembajtjes dhe sinjalistikes , ne rruge , ndertim mbishtresa rrugore , ndertim autostrada , pista aeroporte , helioporte , ndertim tunele rrugore = hekurudhore dhe kompletimi me instalimet e nevojeshme per to .

- Ndertim ura e vepra arti deri 10 ml , ndertim ura dhe vepra arti mbi 10 m , estakada , ura metalike , te varura .
- Ndertim ujesjellesa , kanalizime , kanale e impiante vaditese .Ne fushen e 2 prodhimit te materialeve te ndertimit Prodhim materiale inerte lumore e malore ( Konglomerate) – gure gelqerore nga guroret malore , prodhime elemente betoni e beton arme te zakoneshme , te paranderur , gure dekorative , prodhim materiale lidhes , gelqere , cemento allci , betone , prodhime me baze bitumi e sintentike .
- Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice , te import eksport prekin apo jo kufirin shqiptar te materialeve : ushqimore , industriale , lende te para , makineri e pajisje , automjete te transportit urban e te mallrave , makineri teknologjike ndertimi gjysem te gateshme , produkte , artikuj te konsumit farmaceutik , elektroshtepiake , konfeksione , bime medicinale , kozmetike , prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit , pjese kembimi per makineri te ndryshme , makineri e automjete , , pika servisi , tregetim karburantesh , dhe vajra lubrifikante , hapje dyqane , bar bufe , restorant , hoteleri , si dhe ne fushen e automjeteve , si dhe ne perdorimin e lendeve plasese e shperthyese per nevoja civile, shperthim ne gurore per prodhim materialesh inerte , per perdorime ne germime te natyrave te ndryshme. Qeradhenie

#### Neni 5

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise “SKM J.V” SHPK eshte e pakufizuar.

#### KREU II


#### KAPITALI

#### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000leke (njemijeleke).

- a. Ortaku **STAR CONSTRUCTION shpk** eshte zoterues i nje kuote me vlere nominale 333.3leke (treqind e tridhjetë e tre pike tre leke), qe perben 33.3% te kapitalit themeltar.
- b. Ortaku **Shoqëria KOZMOS IMP-EXP shpk** eshte zoterues i nje kuote me vlere nominale 666.7leke(gjashteqind e gjashte dhjete e gjashte pike shtate leke), qe perben 66.7% te kapitalit themeltar.



*Shemudari gabim, u fshime 4 (katën) rreshta.*

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.



Neni 7



A2023053540017371526

### **Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

### **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;



A2023053540017371526

- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin në çfaredo banke apo institucion financiar kreditor.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 9

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

### Neni 10

#### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 11 Kuorumi



Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këte nen, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 12**  
**Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve të shoqërisë, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shperblimeve,
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen epasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) perfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
  - f) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblese
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

**NENI 13**  
**Perjashtimi nga e drejta e votes**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a. vleresimin e veprimtarisë së tij,
- b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij,
- c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç. Dhenien ose jo të përfitimeve të reja;

Kur ortaku perfaqesohet nga një perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi ashtu si dhe ortaku, të cilin perfaqeson.

**Neni 14**  
**Administrimi**



A2023053340017371526

Shoqeria do te administrohet nga **Z. Albert Allmuça**, atësia Fadil, amësia Qefsere, shtetas Shqiptar, lindur në Mumajes, Tiranë dhe banues në Tiranë, lindur më 12/12/1968, me Leternjoftim ID nr. 035483786 dhe nr. personal G812120390, sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjeçare me te drejte ripërteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqërisë mund te emerohet edhe nje person jashte ortakërisë.

### Neni 15 Kompetencat

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, terheqje, transfertë, etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punës, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Fq. 7





A2023053540017371526

Administratori i shoqërisë nuk ka të drejte të marrë kredi apo hua, nuk ka të drejte të shese apo bleje asnje pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në emer të shoqërisë, si dhe nuk mund të kryje asnje veprim që lidhet me administrimin e jashtëzakonshëm të shoqërisë pa marrë paraprakisht miratimin e asamblese së ortakëve nëpërmjet vendimit të tyre.

### **Neni 16** **Përgjegjësia e administratorit**

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;



A2023053549017371526

- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

### **Neni 17** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **Neni 18** **Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### **Neni 19**

#### **Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

### **Neni 20**

Të ardhurat neto që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tjerëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi të ortakëve.

### **Neni 21**



A2023053540017371526

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunktionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i këtij ligj;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 87, ligjit.

3. Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “d”, dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t’i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkak i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundshme të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të këtij ligji

## Neni 22

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.



**Neni 23**

**Të drejtat e detyrimit e likuiduesit**

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

**Neni 24**

**Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

**Neni 25**

**Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

**Neni 26**

**Ndarja**

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.



A2023053540017371526

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidarë për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- a. kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
- b. bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c. vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

#### Neni 27 Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

#### Neni 28 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këto akt themelimi dhe statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këto akt themelimi dhe statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 29 Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare

#### Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi dhe statut u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nën parimin nga Ortaket e shoqërisë tregtare "SKM J.V" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për



A2023053540017371526

mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**THEMELUES**

**Shoqëria STAR CONSTRUCTION shpk**

perfaqesuar nga administratori:

Albert Allmuça

*Albert Allmuça*  
**Shoqëria KOZMOS IMP-EXP shpk**

perfaqesuar nga administratori:

Ajet Ruzi

*Ajet Ruzi*



**NOTERE**  
**MIMOZA SADUSHAJ**



**VENDIM**  
**I ASEMBLESE SE ORTAKUT TE SHOQERISE**  
**« J620280020» SH.P.K**  
Nr. 3 Date 03.02.2023

Ne Seline e shoqerise ne Tirane, u zhvillua mbledhja e asamblese se ortakut te shoqerise, me pjesemarrjen e ortakut:

**Albert Allmuça**, atësia Fadil, amësia Qefsere, shtetas Shqiptar, lindur në Mumajes, Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Dibres; Nd. Nr.198; Njësia Administrative Nr. 8; Njesia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 12/12/1968 , gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035483786 dhe nr. personal G812120390.

**RENDI I DITES**

1. Themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin „SKM J.V“ shpk.
2. Kapitali themeltar i kesaj shoqerie do te jete 1.000leke (njemije leke).
3. Shoqeria **STAR CONSTRUCTION» SH.P.K**, do te jete ortake me e nje kuote me vlere 333.3leke (treqind e tridhjete e tre pike tre leke), qe perben 33,3% te kapitalit themeltar te shoqerise „SKM J.V“ shpk.
4. Shoqeria « SKM J.V » shpk do te administratohet nga Z. **Albert Allmuça**.

Ne perfundim, pas shqyrtimit te rendit te dites, mbeshtetur ne ligjin “Per QKR“ dhe Ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ortakut i shoqerise:

**VENDOSI**

1. Themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin „SKM J.V“ shpk.
2. Kapitali themeltar i kesaj shoqerie do te jete 1.000leke (njemije leke).
3. Shoqeria **STAR CONSTRUCTION» SH.P.K**, do te jete ortake me e nje kuote me vlere 333.3leke (treqind e tridhjete e tre pike tre leke), qe perben 33,3% te kapitalit themeltar te shoqerise „SKM J.V“ shpk.
4. Shoqeria « SKM J.V » shpk do te administratohet nga Z. **Albert Allmuça**.

Ortak i vetem

Albert Allmuça

*Albert Allmuça*

SHOQERIA « KOZMOS IMP-EXP” SH.P.K  
NIPT J62403013I

VENDIM  
I ASEMBLESE SE ORTAKUT TE SHOQERISE  
« J62403013I» SH.P.K  
Nr. 5 Date 03.02.2023

Ne Seline e shoqerise ne Tirane, u zhvillua mbledhja e asamblese se ortakut te shoqerise, me pjesemarrjen e ortakut:

**Ajet Ruzi**, atësia Haki, amësia Sadet, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Durresit; Nd. 85/1; H. 2; Ap. 10; Njësia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 11/05/1946 , gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 024424652 dhe nr. personal E60511051I.

**RENDI I DITES**

1. Themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin „SKM J.V“ shpk.
2. Kapitali themeltar i kesaj shoqerie do te jete 1.000leke (njemije leke).
3. Shoqeria « **KOZMOS IMP-EXP” SH.P.K**, do te jete ortake e nje kuote me vlere 666.7leke(gjashteqind e gjashte dhjete e gjashte pike shtate leke), qe perben 66.7% te kapitalit themeltar, te shoqerise “ SKM J.V“ shpk.
4. Shoqeria « SKM J.V » shpk do te administratohet nga **Z. Albert Allmuça**.

Ne perfundim, pas shqyrtimit te rendit te dites, mbeshtetur ne ligjin “Per QKR“ dhe Ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ortakut i shoqerise:

**V E N D O S I**

1. Themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin „SKM J.V“ shpk.
2. Kapitali themeltar i kesaj shoqerie do te jete 1.000leke (njemije leke).
3. Shoqeria « **KOZMOS IMP-EXP” SH.P.K**, do te jete ortake e nje kuote me vlere 666.7leke(gjashteqind e gjashte dhjete e gjashte pike shtate leke), qe perben 66.7% te kapitalit themeltar.
4. „SKM J.V“ shpk.
5. Shoqeria « SKM J.V » shpk do te administratohet nga **Z. Albert Allmuça**.

Ortak i vetem  
**Ajet Ruzi**

• **KOZMOS** Shpk  
Tirane  
Tel Num 048 /  
ALBANIA






## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J620280020
2. Data e Regjistrimit	01/01/1996
3. Emri i Subjektit	STAR CONSTRUCTION
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	02/06/1994
6. Kohëzgjatja	Nga: 02/06/1994
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Ndre Mjeda, Zona Kadastrale 8220, Nr.Pasurie 7/260, 7/259, 7/336, 7/33, 7/34,
8. Kapitali	478.000.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Ne fushen e projektimit ne Ndertim , studime plane racionale urbanistike, plane rregullues te pergjithshem per qendra te banuara , qytete , studime urbanistike , studime pjesore urbanistike , projektme objekte civile , industriale , turistike deri pese kate , projektme objekte civile , industriale , turistike mbi pese kate , projektme objekte sportive , projektme interiere , projektim pejsazhesh sistemime siperfaqe te gjelbera lulishte . furnizim me uje , kolektore shkarkimi , ujesjellesa kanalizime urbane , rurale , rruge auto kategoria V e IV , projektim shtresa rrugore e sistemim asfaltim , projektim urra e vepra arti deri 10 m , Ne zbatim ne Ndertim germime dhe ne punime eventuale , murature e beton arme , prishje dhe ne toke te germuar , Ndertime civile industriale , turistike , bujqesore deri 5 kate ndertime civile industriale turistike bujqesore mbi pese kate , rikonstruksione .Ndertim banese me skelet mbi tete kate , Ndertim rruge kategoria IV e V , ndertim rruge kategoria III , II , I , punime te mirembajtjes dhe sinjalistikes , ne rruge , ndertim mbishtresa rrugore , ndertim autostrada , pista aeroporte , heliopoarte . ndertim tunele rrugore – hekurudhore dhe kompletimi me instalimet e nevojeshme per to .Ndertim ura e vepra arti deri 10 ml , ndertim ura dhe vepra arti mbi 10 m , estakada , ura metalike , te varura .Ndertim ujesjellesa , kanalizime , kanale e impiante vaditese .Ne fushen e



	<p>prodhimit te materialev te ndertimit Prodhim materiale inerte lumore e malore ( Konglomerate) – gure gelqerore nga guroret malore , prodhime elemente betoni e beton arme te zakoneshme , te paranderur , gure dekorative , prodhim materiale lidhes , gelqere , cemento allci , betone , prodhime me baze bitumi e sintentike . Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice , te import eksport prekin apo jo kufirin shqiptar te materialeve : ushqimore , industriale , lende te para , makineri e pajisje , automjete te transportit urban e te mallrave , makineri teknologjike ndertimi gjysem te gateshme , produkte , artikuj te konsumit farmaceutik , elektroshtepiake , konfeksione , bime medicinale , kozmetike , prodhim e tregetim te materialeve te ndertimit , pjese kembimi per makineri te ndryshme , makineri e automjete , , pika servisi , tregetim karburantesh , dhe vajra lubrifikante , hapje dyqane , bar bufe , restaurant , hoteleri , si dhe ne fushen e automjeteve , si dhe ne perdorimin e lendeve plasese e shperthyese per nevoja civile, shperthim ne gurore per prodhim materialesh inerte , per perdorime ne germime te natyrave te ndryshme. Qeradhenie</p>	
10. Administratori/ët	Albert Allmuça	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 17/09/2012	Deri: 08/09/2025
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	AlbertAllmuça	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 478.000.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Tirane TIRANE Rruga " Egnatia ", Njësia Administrative nr.11, Zona Kadastrale 8310, Nr.Pasurie Nr.7/817, Nr.7/925, Nr.7/339, Nr.7/632, Nr.7/927, Nr.7/101, Nr.7/879, Nr.7/102, Nr.7/923	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: STAR CONSTRUCTION E-Mail: lonaallmuca@yahoo.com Telefon: 0696007744 Të Tjera: Me vendimin Nr. 1 te asamblese se ortakeve te shoqerise XHEKER shpk, date 03.05.2008 eshte caktuar eksperte kontabel e autorizuar per rritjen e kapitalit Zj. Lumturie Brahaj me numer license nr. 121 date	



	<p>10.01.2001.Me vendimin te asamblese se ortakeve te shoqerise XHEKER shpk, date 30.06.2009 eshte caktuar eksperte kontabel e autorizuar per rritjen e kapitalit Zj. Lumturie Brahaj me numer license nr. 121 date 10.01.2001. Me vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise XHEKER shpk, date 26-05-2010 eshte caktuar eksperte kontabel e autorizuar per rritjen e kapitalit Zj. Lumturije Brahaj me numer license nr. 121 date 10.01.2001.</p>
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 03/02/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga Web



## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J624030131	
2. Data e Regjistrimit	16/09/1996	
3. Emri i Subjektit	KOZMOS IMP-EXP	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	06/09/1996	
6. Kohëzgjatja	Nga: 06/09/1996	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE JORDAN MISJA 15	
8. Kapitali	200.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Import-eksport te mallrave industriale, ushqimore, aktivitet ne fushen e ndertimeve, projekttimeve, etj	
10. Administratori/ët	Ajet Ruzi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 06/09/1996	Deri:
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	AjetRuzi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 200.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Tirane TIRANE M GJOLLESHA (TREGU FRUTA PERIM	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: KOZMOS IMP-EXP Telefon: 0692054186 Të Tjera: Depozitim i vendimit te ortakut te vetem date 16.06.2008 per miratimin e bilancit te vitit 2007	
15. Statusi:	Aktiv	



Datë: 03/02/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web